



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 18 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës NR. 06/L-092, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 3 prill 2019 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes bën këtë:

**FTESE PUBLIKE
PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË ANKESAVE
NGA SHOQËRIA CIVILE**

(VAZHDIM I AFATIT PËR APLIKIM)

Ftohen përfaqësuesit e Organizatave Joqeveritare - Shoqërisë civile të cilat veprojnë dhe kanë selinë në territorin e Komunës së Lipjanit, të dërgojnë propozimet e tyre për anëtarësim në Komisionin e ankesave i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës **pasi është vazhduar afati për aplikim.**

Numri kërkuar : **1 (një) anëtarë** nga Shoqëria civile.

Propozimet sipas mundësisë duhet të përfshijë personat me prioritet nga lëmi i shkencave juridike, ekonomike, shoqërore apo të ndonjë lëmie tjetër të pregaditjes superiore.

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet ti drejtohen Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati përdhësë në Qendrën për shërbime për qytetarë më së largu me datë **11.05.2026**.

Ftesa të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr 020/04-7170
Më datë: 09.02.2026

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti

